VENDIM
Nr.522, datë 13.5.2009

PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE, NË SHKALLË VENDI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 111 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1996 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 2 e 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paga bazë minimale mujore për punonjësit, në shkallë vendi, e detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo person juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 18 000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë.
2. Paga bazë minimale mujore jepet për 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës.
3. Paga bazë minimale orare të jetë 103 (njëqind e tre) lekë.
4. Shtesat me karakter të përhershëm jepen mbi pagën bazë.
5. Vendimi nr.995, datë 2.7.2008 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e pagës minimale, në shkallë vendi", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha